

## Vendim nr. 185 datë 19.09.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, anëtarë, në datën 19.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (O) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** OLSI AVDIJA

**OBJEKTI:** Ndreqje gabimi material në vendimin nr. 148, datë 27.06.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Olsi Avdija i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankimin kushtetues individual të datës 16.04.2024, me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për hetim brenda një afati të arsyeshëm të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 5864 të vitit 2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin dhe mbylljen e hetimit.

2. Me vendimin nr. 148, datë 27.06.2024 (*vendimi nr. 148/2024*), Mbledhja e Gjyqtarëve të kësaj Gjykate ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

3. Pasi ky vendim është publikuar në faqen zyrtare dhe i është njoftuar palës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesën e datës 26.07.2024, me objekt ndreqjen e gabimit material në vendimin nr. 148/2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

4. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtuar:

4.1. Në paragrafin 3 të vendimit nr. 148/2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve është shkruar gabimisht numri i procedimit penal të regjistruar në bazë të kallëzimit të tij penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili në paragrafin e mësipërm mban nr. 6864 të vitit 2015, ndërsa në ankimin kushtetues individual është shënuar me nr. 5864 të vitit 2015. Në kushtet kur ky gabim mund të ndikojë në aplikimin pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) dhe mund të krijojë konfuzion te palët, Mbledhja e Gjyqtarëve duhet të ndreqë gabimin material në vendim.

4.2. Faktet e shënuara në vendimin nr. 148/2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve nuk janë ato që janë parashtuar nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual. Ato janë marrë nga vendimi i regjistrimit të procedimit penal të prokurorit të çështjes, edhe pse në vijim të këtij vendimi ka kallëzime dhe të dhëna të tjera, vendime të gjykatave dhe të prokurorit, fakte e veprime procedurale, siç janë aktet e ekspertimit, të cilat kanë ndryshuar situatat e kallëzimit të parë nga data 12 maj 2015 deri në datën 4 prill 2024. Gjykata mund të verifikonte në vendimet e paraqitura aktet e ekspertimeve, nëse do të merrte informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për të kuptuar se bëhet fjalë për falsifikime që kanë sjellë si pasojë vjedhje parash, cenim të të dhënave personale etj. Veprimi më i fundit i kërkuetit ka qenë kërkesa para organit procedues në datën 07.02.2024 për mbylljen e hetimeve, pasi është vërtetuar shkencërisht me prova falsifikimi e vjedhja e supozuar. Cenimi i të dhënave personale është pranuar nga të kallëzuarit. Kjo kërkesë nuk është paraqitur në vendimin nr. 148/2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

4.3. Vendimi nr. 148/2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve duhet të ndryshohet dhe çështja duhet të shqyrtohet në seancë plenare, pasi legjitimon pafundësinë e hetimeve penale dhe është në kundërshtim me vendimet e GJEDNJ-së. Të

drejtat e viktimës së veprave penale, qoftë kjo e supozuar, nuk përfillen edhe pse mbrohen me ligj, mbrojtje e cila është formale. Në procedurën dhe hetimet paraprake viktimat e veprës penale mbrohet nga nenet 1, 9/a dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), qoftë edhe në mënyrë të supozuar, për sa kohë që nuk ka një vendim të formës së prerë. E drejta për t'u formuar si palë civile, si dhe padia civile parashikohen nga nenet 61 dhe 62 të KPP-së. Legjitimimi mund të bëhet nga organi procedues, pa filluar shqyrtimi gjyqësor ose seanca paraprake për pushimin e çështjes ose kalimin në gjyq.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimimin e kërkuarit

5. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në lidhje me kërkesën në shqyrtim, nëpërmjet së cilës kërkuari ka kërkuar ndreqjen e gabimit material të vendimit nr. 148/2024, në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe në nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (Rregullorja) parashikohet se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose i Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohet. Gjykata kryesisht ose me kërkesë të palëve, e cila duhet të paraqitet brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit, ka të drejtë të plotësojë vendimin ose të ndreqë gabimin në shkrim, llogaritje ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të. Kompetencën për shqyrtimin e kërkesës e ka i njëjti Kolegj që ka dhënë vendimin, Mbledhja e Gjyqtarëve ose Gjykata, sipas llojit të vendimit që kërkohet të saktësohet, plotësohet ose ndreqet.

6. Në kuptim të parashikimeve të mësipërme, në rastin konkret Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, sepse ka qenë kërkuar, pra një prej palëve në procesin në të cilin është dhënë vendimi nr. 148/2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi është i datës 27.06.2024, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 26.07.2024, pra brenda afatit 2-mujor të parashikuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000.

7. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, në kuptim të kompetencës lëndore të Gjykatës, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se sipas kërkuarit në paragrafin 3 të vendimit nr. 148/2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve është shkruar gabim numri i procedimit penal të regjistruar në bazë të kallëzimit të tij penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në paragrafin 3 të vendimit procedimi penal mban nr. "6864" të vitit 2015, ndërsa në ankimin kushtetues individual procedimi penal është shënuar me nr. 5864 të vitit 2015.

8. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se në vendimin nr. 148/2024 procedimi penal i regjistruar në bazë të kallëzimit penal të kërkuesit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është përmendur në disa paragrafë të tij. Në paragrafin 3, rreshti 2 dhe paragrafi 7, rreshti 4, të këtij vendimi, procedimi penal mban nr. “6864” të vitit 2015, ndërkohë që referuar vendimeve të gjykatave të faktit, ai mban nr. “5864” të vitit 2015. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në rastin konkret, në këta paragrafë të vendimit nr. 148/2024, është bërë një gabim në shkrim në lidhje me numrin e procedimit penal të organit të akuzës, i cili nevojitet të ndreqet për këtë shkak.

9. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi, ndër të tjera, pretendon se faktet e shënuara në vendimin nr. 148/2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve nuk janë ato që janë parashtruar nga ana e tij në ankimin kushtetues individual. Sipas tij, ato janë marrë nga vendimi i regjistrimit të procedimit penal të prokurorit të çështjes, edhe pse në vijim të këtij vendimi ka kallëzime dhe të dhëna të tjera, vendime të gjykatave dhe të prokurorit, fakte e veprime procedurale, siç janë aktet e ekspertimit, të cilat kanë ndryshuar situatat e kallëzimit të parë nga data 12 maj 2015 deri në datën 4 prill 2024. Lidhur me këtë pretendim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se faktet dhe rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi janë bazuar në vendimet gjyqësore dhe aktet e tjera të dërguara bashkëlidhur ankimit kushtetues individual. Ato janë paraqitur në mënyrë korrekte dhe kronologjike, duke iu referuar këtyre akteve, për aq sa është konsideruar e nevojshme për shqyrtimin e rastit konkret. Si rrjedhim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

10. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se vendimi nr. 148/2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve duhet të ndryshohet dhe çështja duhet të shqyrtohet në seancë plenare, pasi legjitimon pafundësinë e hetimeve penale dhe është në kundërshtim me vendimet e GJEDNJ-së. Për sa i përket këtij pretendimi, në referim të objektit dhe përmbajtjes së kërkesës, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se ndonëse kërkuesi e ka paraqitur atë në kuptim të nenit 80 të ligjit nr. 8577/2000, në thelb ai kundërshton qëndrimin e mbajtur nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe mënyrën e trajtimit të pretendimeve të tij në vendimin nr. 148/2024. Pavarësisht argumenteve të ngritura në kërkesë, vendimmarrja e Mbledhjes së Gjyqtarëve, si dhe procedura e ndjekur prej saj në përputhje me parashikimet e ligjit organik dhe Rregullores nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli as prej vetë Gjykatës, pasi edhe vendimet e dhëna në fazën e shqyrtimit paraprak nga Mbledhja e Gjyqtarëve kanë natyrë përfundimtare (*res judicata*). Në këtë kuptim, për sa kohë që ky pretendim nuk përfshihet në rastet e parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe në nenin 43 të Rregullores, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se nuk mund të merret në shqyrtim.

11. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson të ndreqë gabimet materiale në paragrafin 3, rreshti 2 dhe paragrafin 7, rreshti 4, të vendimit nr. 148/2024, ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuarit, ajo vlerëson se kërkesa nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31, 31/a dhe 80, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Saktësimin dhe ndreqjen e gabimit në shkrim në vendimin nr. 148, datë 27.06.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, si më poshtë:
  - a) Në paragrafin 3, rreshti 2, numri i procedimit penal nga “6864” bëhet “5864”;
  - b) Në paragrafin 7, rreshti 4, numri i procedimit penal nga “6864” bëhet “5864”.
3. Mospranimin e kërtimeve të tjera.
4. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr. 148, datë 27.06.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.